

## Shenimet shpjeguese per Pasqyrat Financiare 2019 - RAPORT KONTABEL

### **Shënimet për pasqyrat financiare**

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019  
(Të gjitha balancat janë në lekë).**

#### **1. Informacione te pergjitheshme**

"MC.CATERING" sh.p.k, eshte themeluar si një shoqer me perjegjesi te kufizuar me 15/10/2007. Kapitali regjistruar eshte 3,931,000 leke dhe zoterohet 100% nga ortaku z Gentjan PRENCI. Veprimtaria kryesore treglare e shoqerise per ushtrimin 2019 eshte tregtimi i artikujve ushqimor me pakice, shumice dhe te artikujve te tjera industrial, bazuar ne kontrata furnizimi ne fushen e Prokurimeve Publike .

#### **2. Permbledhje e politikave kontabel**

##### **Bazat e pergalitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë pergalitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergalitur mbi bazën e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te konstatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ('lekë).

*Ne paraqiten e pasqyrave financiare te viti 2019 eshte zbatuar formati i SKK-2 i permiresuar dhe ligji Nr 25/2018 date 10/05/2018 dhe per rjedhim zera e pasqyrave financiare te periudhes ushtrimore janë te njejtë me ato te viti ushtrimor 2018.*

##### **Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:**

###### **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet nijhen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve nijhen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve nijhen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në dalën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet nijhen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

###### **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit nijhet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2019 janë 1 EUR=121,77 leke dhe 1 USD= 108,64 leke.

###### **Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatushem i cili ndryshon nga fitimi tegetar që raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimi i tatushme sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2019 eshte 15 %.



## Shenimet shpjeguese per Pasqyrat Financiare 2019 - RAPORT KONTABEL

### Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provisionet e krijuara për rënien në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstaluara dhe huamarje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

### Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e vleres se mbetur. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumular dhe ndonjë humbje të akumular nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejt përdrejt në kapitalet e veta nën zërin "lepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zgjedohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zgjelim nijhet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes se vleres se mbetur. Normat e perdonura te amortizimit jane 20 % dhe 25 % te vleres se mbetur.

### Gjendjet e inventaret

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

#### 1. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mijet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 janë si me poshtë:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2019		Gjendja ne 31.12.2018	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	15,736,924		1,740,196	-
Arka ne leke	LEK	2,372,580		1,279,318	-
Garanci Bankare	LEK				
Shuma		18,109,504	0	3,019,514	0

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare janë te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne arke. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit te fundit te ushtrimit te bankes respective.

#### 2. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
<b>Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme(klient)	14,978,944	46,157,900
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme(Talimat) 14,978,944		531,841
(iii) Te kreditueshme nga shtetie i(Tvsh)		
(iv) Investime të tjera financiare		
(v) Debitore te tjere		
Shuma	37,900,000	10,000,000
	52,878,944	56,689,741



## Shenimet shpjeguese per Pasqyrat Financiare 2019 - RAPORT KONTABEL

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar faturat e përkuduara te klienteve te ndryshem me te cilet shoqeria ka marredhenie financiare.

Drejimi mendon se te gjitha kërkesat do te arketohen ne një periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon rerie ne vlerë. Kërkesa te tjera "TVSH" është paraqitur vlera e TVSH se mbipaguar per vitin ushtrimor.

Ne llogarine Debitore te tjere është paraqitur shuma prej 37,900,000 leke që shoqeria MC CATERING shpk i ka dhene borxh shoqerise REGLI SHPK ne shumen 10,000,000 leke shpk sipas kontrates se huadhenies dhe shoqerise EAGLE CONS shpk 27,900,000 leke per tu kthyer gjatë vitit 2020.

### **3. Inventari**

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
<b>Inventari</b>		
(i) Lëndët e para	-	-
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për shitje	1,219,219	3,797,384
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
<b>Shuma</b>	<b>1,219,219</b>	<b>3,797,384</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershëm. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte përdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Shuma e inventarit te paraqitur ne "Mallra per shitje" perfason stokun e mallrave, te vleresuara me kostot e blerjes. Drejimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

### **4. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te) dhe Jo Materiale (AAJM)**

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve +AAJM me 01.01.2019	-	-	620,011	-	620,011
Shtesat	-	-	17,500	-	17,500
Pakesimet	-	-	-	-	-
<b>Kosto e AAM-ve +AAJM me 31.12.2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>637,511</b>	<b>-</b>	<b>637,511</b>
B Amortizimi AAM-ve + AAJM me 01.01.2019	-	-	136,161	-	136,161
Amortizimi ushtrimit	-	-	136,161	-	136,161
Amortizimi per daljet e AAM-ve+AAJM	-	-	-	-	-
<b>Amortizimi i AAM-ve +AAJM 31.12.2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>136,161</b>	<b>-</b>	<b>136,161</b>
C Zhvleresimi AAM-ve + AAJM 01.01.2019	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
<b>Zhvleresimi AAM-ve + AAJM 31.12.2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
D Vlera neto e AAM-ve + AAJM 01.01.2019	-	-	620,011	-	620,011
<b>Vlera neto e AAM-ve + AAJM 31.12.2019</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>501,350</b>	<b>-</b>	<b>501,350</b>



## Shenimet shpjequese per Pasqyrat Financiare 2019 - RAPORT KONTABEL

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve dhe AAJM te pasqyruara ne blanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria ka kryer ne fund te muajit dhjetor . Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve dhe AAJM, shoqeria ka zgjedhur modelin e vleres se mbetur(SNK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumular dhe ndonje humbje te akumular nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se per gjithesht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlore te AAM-ve dhe AAJM dhe nuk ka illogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve dhe AAJM te perdonura jane 25 % per paisjet informatike dhe 20 % per paisjet e tjera, jo me shume se ato qe perdoren per qellime fiskale.

Masa e illogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijt e njohur per efekte fiskale.

### **5-Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet-shpenzime te periudhave te ardhme**

### **6-Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet**

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
<b>Huatë dhe parapagimet</b>		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	48,083,388	39,449,461
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	2,493,640	846,316
(iii) Detyrimet tatimore(TAP)	9,750	10,400
(iv) Te tjera detyrime (Sig shoqerore)	75,018	74,492
(v)Detyrime ndaj shtetit per TVSH	509,183	
(viii) Tatim mbi fitimin	1,228,526	443,389
(vi) Te tjera tatime per tu paguar (Tatimi ne Burim)	13,800	13,800
(vii)Kreditore te tjere		
<b>Shuma</b>	<b>52,413,305</b>	<b>40,837,858</b>

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergalitur inventaret kontabel dhe shuma e illogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e illogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne fund te ushtrimit.

"Detyrimet tatimore per sig.shoqerore", Tatim qeraje, Tatim Fitimi , kjo e korrektuar sipas rezultatit me parapagimet gjate vitit .

### **7-Kapitalet e veta**

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i 3931.000 leke, i ndare ne 100 kuota me vlore nominale 39.310 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel shoqeria nuk ka bere rritje ne kapitalin e regjistruar te shoqerise dhe , ndryshime ne raportet e zoterimit nga ortaku nuk ka. Fitimet e pasperndara jane 0 leke dhe Rezerva e detyrueshme ligjore eshte 1,187,669 leke. Sipas Vendimit te Ortakut per miratimin e PF 2018, shoqeria ka shperndare fitimin e vitit 2018 dhe fitimet e pasperndara ne formen e dividientit ne shumen 18,170,123 leke, dhe per kete ka paguar Tatimin mbi dividentin.



## Shenimet shpjeguese per Pasqyrat Financiare 2019 - RAPORT KONTABEL

### **8-Fitimi (humbja) e vilit finanziar**

- **Te ardhurat**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2018	31
<b>Te ardhurat nga shitja e produkteve</b>	118,971,063	121,672,565	
Rritje Te Ardhurash nga Raport Kontrolli			
Te ardhurat nga kryerja e punimeve ne ndertim			
Te ardhurat te tjera	240,000	240,000	
<b>Shuma</b>	119,211,063	121,912,565	

Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe sherbimeve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme te zhveshura nga TVSH-ja. Paraqita ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre dhe e mbeshtetur ne parimin e te drejtave te kontstatuara. Nga shitja e produkteve janë realizuar Te Ardhura ne vleren prej 118,971,063 leke dhe 240,000 leke janë te Ardhura nga Qeraja.

- **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave dhe sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit janë treguar ne pasqyren perkatese.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Materialet e konsumuara	(99,762,936)	(99,762,936)
Kosto e punes	(4,169,341)	(4,169,341)
1-Paga personelli	(3,572,700)	(3,572,700)
2-Sigurime shoqerore dhe shendetshore	(596,641)	(596,641)
3-Te tjera personeli		
Amortizime dhe zhvleresime	(277,976)	(277,976)
Shpenzime te tjera	(6,077,199)	(6,077,199)
<b>Shuma</b>	(110,287,452)	(110,287,452)

Materialet e konsumuara te njohura ndryshe si KMSH = 93,505,369 leke dhe 42,818 leke konsum energjie.

Ne zerin shpenzime te tjera bejne pjese: 74,887 leke blerje kancelarie dhe te ngjashme, 11,250 leke blerje ta pastokueshme, 87,734 leke janë shpenzime te per gjithshme 1,269,600 leke janë qera objektesh dhe makinash, 146,667 leke janë mirembajje e riparime, 65,634 leke janë sigurime ofertash dhe kontratash per pjesemarrje ne tendera, 100,000 leke eshte kosto Auditimi dhe shpenzime juridike, 160,680 leke janë taxa dhe tarifa vendore.

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diferenca e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standardeve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)		
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)		
Shpenzime te tjera Financiare-sherbime bankare etj		
Humbje-Fitim nga kursi i këmbimi 769, 670(-)		
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		
<b>Shuma =</b>		
Shoqeria ka shpenzuar 36,901 leke komisione bankare	(36,901)	(22,402)
	(36,901)	(22,402)



## Shenimet shpjeguese per Pasqyrat Financiare 2019 - RAPORT KONTABEL

### **Fitimi i ushtrimit dhe tatimi mbi fitimin**

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 dhe 2018 janë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
<b>I FITIMI NETO PARA TATIMIT</b>	<b>17,855,345</b>	<b>11,602,711</b>
<b>II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)</b>	-	-
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime priteje e dhurime tej kufirit tatumor	-	-
3 Gjoba, penalitete, demshperblime	-	-
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera (paga likuiduar me arke)	-	-
<b>III PJESA E HUMBES SE MBARTUR(-)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)</b>	<b>17,855,345</b>	<b>11,602,711</b>
<b>V Shpenzimi i tatim fitimit-15%</b>	<b>2,678,302</b>	<b>1,740,407</b>
<b>VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)</b>	<b>15,177,043</b>	<b>9,862,304</b>

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem i cili ka dale pasi i jane shtuar fitimit te ushtrimit edhe shpenzimet e pazbriteshme .

### 9-Transaksione te paleve te lidhura

Ne marjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

### 10-Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne vitin ushtrimor 2019 norma e fitimit tregetar dhe kontabel krahasuar me vitin 2018 eshte permiresuar.

### **Shifrat krahasuese**

Shifrat krahasuese te deklaruara ne pasqyrat financiare 2019 jane te krahasueshme me ato te pasqyrave te ushtrimit 2018.

**HARTUESI I BILANCIT**

*Hysen ZYBERAJ*

*VITI 2019*



**ADMINISTRATORI**

*Gentjan PRENCI*